



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Datë/a	22.07.2022
Për/za/to:	Rektorët e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës
Nga/od/from:	Prof. Ass. Dr. Hasnije Ilazi, Kryetare KShC-së
Tema/subjekat/subject:	Njoftim



Të nderuar,

Në mbledhjen e 101-të të KShC-së, të mbajtur më 30.06.2022, është diskutuar mbi verifikimin e bartëseve të programeve dhe personelit akademik të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë.

Ekzistojnë indikacione të qarta dhe të verifikueshme për veprime të IAL-ve si në vijim:

- Lëvizja nga ana e IAL-ve të bartësve të programeve në programet e akredituara, pa kërkesë zyrtare në AKA dhe pa aprovim nga KShC;
- Listimi i personelit akademik që nuk janë në Kosovë si bartës të programeve;
- Përfshirja e personelit akademik me kontratë të skaduar;
- Përfshirja e personelit akademik të padeklaruar për vitin përkatës akademik.

Për të siguruar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e kushteve mbi të cilat programet studimore janë akredituar, me këtë letër ju informojmë se mos respektimi i kushteve të akreditimit dhe deklarimet jo të sakta dhe të pavërteta, me automatizëm do të rezultojnë në tërheqjen e akreditimit të programeve përkatëse, përkatësisht akreditimit institucional, veprime këto të parapara me legjislacionin (UA 15/2018, Neni 21).

Njëkohësisht, AKA do të vazhdojë me vizitat monitoruese dhe pas-akredituese sipas Nenit 29, UA 15/2018, dhe Metodologjisë së Monitorimit të aprovuar nga KShC-ja, gjë që do të ngritë nivelin e evidentimit të gjendjes reale në terren.

Ju lutem konsideroni këtë letër si mundësi për të vepruar më kohë, në respektimin e vendimeve të KShC-së dhe legjislacionit në fuqi.

Duke besuar se arsimi i lartë, cilësor dhe kredibil është qëllim i yni i përbashkët, kërkojmë nga ju veprime konkrete dhe më kohë, duke ju ofruar njëkohësisht bashkëpunim dhe përkrahje në këtë drejtim.

Me respekt,